



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gurëbardhi shpk" të datës 15.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET si e palejuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gurëbardhi shpk" të datës 15.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Gurëbardhi shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 15.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se parashtresi nuk e ka ngarkuar kërkesën për rishqyrtim përmes funksionit "Kërkesa për rishqyrtim" në kuadër të platformës eprokurimi. Përmes nenit 60 par. 1 të RRPP përcaktohet shprehimisht se "Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni "kërkesat për rishqyrtim" brenda afateve të mëposhtme".

Në rastin konkret parashtresi nuk e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim përmes funksionit "kërkesat për rishqyrtim" por përmes funksionit "Dokumentet - Letrat standarde". Pra parashtresi nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar me nenin 60.1 të RRPP. Në anën tjetër përmes nenit 62.1 par. c) përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim duhet të refuzohet nëse "Kërkesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në nenin 60.1 dhe nenin 60.2 të kësaj rregullore". Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtresit duhet të refuzohet si e palejuar.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur po ashtu se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. b) është përcaktuar se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)". Në rastin konkret njoftimi mbi vendimin është publikuar me datë 08.05.2024 pas orës 16:00 që nënkupton se data 09.05.2025 është dita zero (0), pastaj data 10.05.2025 është dita një (1), data 11.05.2025 është dita dy (2), ndërsa data e fundit kur kanë mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka qenë data 14.05.2025 deri në ora 16:00. Në rastin konkret kërkesa për rishqyrtim është ngarkuar me datë 15.05.2025 dhe si e tillë kjo kërkesë e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është e pasafatshme dhe duhet hedhet poshtë si e palejuar.

Sa i përket konstatimit të parashtruesit që nuk është lejuar qasja në dokumente, përmes eprokurimit mund të konfirmohet se parashtruesi ka ngarkuar kërkesën për qasje në eprokurim me datë 13.05.2025. Ndërsa qasja është lejuar me datë 14.05.2025.

Dërguar në: GURËBARDHI SH.P.K., EING COM SH.P.K.		✓✓
Dokumenti për dërgim te OE		
NJOFTIM.pdf		14.05.2025 10:29
Hape:	Shqip 📅 📄	
Ngarko:	📄 Shqip 📄 Srpski 📄 English	📤 Dërgo



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

NJOFTIM

AK ju njofton në lidhje me kërkesën tuaj të parashtruar për qasjen në dokumente për procedurën e prokurimit: "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. Prokurimi: 616-25-1169-5-1-1

AK e ka aprovuar kërkesën tuaj për qasje, dhe ju lejohet qasja sot me datë 14.05.2025 në ora 15:00, si dhe nesër me datë 15.05.2025 nga ora 09:00 deri në përfundim të orarit.

Me respekt:

Sektori i Prokurimit

Prishtinë, 14.05.2025

Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.